



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 02.12.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.11.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Green Energy Kosova" për aktivitetin: <"Organizimi i punetorive lidhur me informimin e aktereve me interes për kriteret e efikasitetit të energjisë në ndertesa" dhe me numër të prokurimit: 616 -19—7664-236 nxjerr:

### VENDIM

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Green Energy Kosova" e datës 28.11.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Organizimi i punetorive lidhur me informimin e aktereve me interes për kriteret e efikasitetit të energjisë në ndertesa" dhe me numër të prokurimit: 616 -7664-236 kundër Njoftimit të Vendimit për dhënje të kontratës të AK-së, të datës 26.11.2019, të publikuar në Platformën elektronike E Prokurimit të KRPP-së.

1. Vertetohet Njoftimi i Vendimit i publikuar me datë: 26.11.2019 dhe Autoriteti Kontraktues vazhdon aktivitetin sipas të njejtit;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetim

Operatori Ekonomik "Green Energy Kosova" me datë 28.11.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit me titull: "Organizimi i punetorive lidhur me informimin e aktereve me interes për kriteret e efikasitetit të energjisë në ndertesa" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-7664-236.

Autoriteti Kontraktues, me datë 02.12.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar e harmoni me kërkesat e Rregullave për tenderet jonormalisht të ulet nuk është i bazuar pasi që Autoriteti Kontraktues në procesin e rivlerësimit ka kërkuar sqarimet dhe i ka pranuar të


njejtat. Komisioni i ka konsideruar sqarimet si te mjaftueshme dhe duke u bazuar edhe ne parimin baze-shfrytezimin efikas te mjeteve publike ka rekomanduar me te drejt per dhenje te kontrates tenderuesin me çmimin me te ulet.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit duke u bazuar në konstatimet paraprake ka vendosur si ne dispozitiv dhe Autoriteti Kontraktues vazhdon proceduren sipas Njoftimit te dates 26.11.2019.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, pretenduesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit,



Vendimi u dërgohet:

- Palës ankuese(nepermes Platformes elektronike);
- Njesisë së kërkesës;
- Departamentit të Prokurimit;dhe
- Anëtarëve të komisionit